

Ligji Nr.10 236, datë 18.2.2010

“Për marrjen në kontroll të shoqërive me ofertë publike”.

Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri legjislatori ka pasur si **qëllim** përcaktimin e rregullave që lidhen me kushtet dhe procedurat për marrjen në kontroll **të shoqërive me ofertë publike** (është shoqëria aksionare me ofertë publike e cila regjistron aksionet e saj në kuotim burse). **Fusha e zbatimit** të ligjit mbulon ofertat e shpallura publikisht me marrjen në zotërim të titujve të emetuar nga një **shoqëri publike** me seli në territorin e Shqipërisë dhe të huaja me seli brënda dhe jashtë territorit të Shqipërisë. Shoqëritë aksionare, subjekte të këtij ligji kanë për detyrë të publikojnë disa të dhëna që janë të parashikuara në mënyrë tasative në ligj.

Është e rëndësishme të japim shpjegimin e termit **“Tituj”** si instrumente financiare, të cilat emetohen dhe tregtohen për sigurimin e fitimit, nëpërmjet administrimit të të drejtave, që rrjedhin nga zotërimi i tyre. Në termin **“tituj”** përfshihen pa kufizim aksionet, obligacionet e shoqërive tregtare dhe të pushtetit vendor, bonot e thesarit dhe obligacionet e emetuara nga shteti shqiptar, titujt e emetuar nga Banka e Shqipërisë, dëftesat tregtare, aksionet ose kuotat e fondeve të investimit, si dhe instrumente të tjera financiare, të krahasueshme me aksionet dhe obligacionet dhe që vlerësohen dhe miratohen si të tilla nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

Në kuptim të këtij ligji, **oferta për marrje në kontroll** është oferta e shpallur publikisht për të marrë në zotërim titujt e një shoqërie, objekt i ofertës, nga një ofrues, i cili, synon të kalojë kufirin e kontrollit për shoqërinë, objekt i ofertës. Kjo ofertë i drejtohet të gjithë aksionarëve të shoqërisë, objekt i ofertës, për të gjitha aksionet e shoqërisë. Njoftimi i vendimit për të bërë ofertën ndjek disa faza dhe procedura të parashikuara në mënyrë të detajuara nga ligji dhe që duhet respektuar nga subjektet objekt të këtij ligji. Ligji parashikon angazhimin e një **këshilltari financiar të paanshëm** për t'u këshilluar, nëse oferta është e pandershme dhe e paarsyeshme i cili caktohet nga bordi drejtues i një shoqërie. Gjithashtu në rast se njëri nga drejtuesit e bordit drejtues të shoqërisë ofruese është në konflikt interesash krijohet një **komitet i pavarur** për të bërë vlerësimin e ofertës së propozuar. Komiteti i pavarur i bordit përbëhet nga drejtues të cilët nuk kanë interes të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë në ofertën që shqyrtojnë. Ligji parashikon dhe rastet e ofertave të cilat janë të ndaluara nga autoriteti, i cili ka kompetencë të këshillojë dhe të diskutojë me ofruesin çështjet për të korrigjuar veprimet apo mosveprimet e tij, që nuk janë në përputhje me dispozitat e këtij ligji. Në rast se oferta për marrjen në kontroll nuk lejohet dokumenti i ofertës nuk publikohet. Kontrata për blerjen e titujve të shoqërisë objekt i ofertës që mbështetet në një ofertë të ndaluar është e pavlefshme.

Përgjegjësia për vërtetësinë e dokumentit të ofertës i mbetet Ofruesit i cili mban përgjegjësi dhe për dëmet e shkaktuara aksionarëve të cilët e kanë pranuar ofertën, me përjashtim të disa rasteve të parashikuara në ligj kur ofruesi provon se nuk ka qenë në dijeni të këtyre mangësive.

Ofruesi ka të **drejtë të revokojë** ofertën për marrje në kontroll, përveç rastit kur ka përfunduar periudha kohore e lejuar për të pranuar ofertën. Koha e lejuar për pranimin e ofertës për marrje në kontroll nuk duhet të jetë më pak se 3 javë dhe më shumë se 10 javë nga data e publikimit të dokumentit të ofertës. Ofruesi duhet të ofrojë një **çmim të drejtë** për aksionet e të njëjtit lloj apo kategori të shoqërisë, objekt i ofertës. Autoriteti nxjerr rregulla të detajuara për mënyrën e përcaktimit të çmimit të drejtë. Pagesa e ofruar nga ofruesi duhet në mjete monetare ose në aksione të tregtueshme në tregun e organizuar, nëse aksionet janë mjaftueshmërisht likuide dhe aktive.

Vlerësimi nga ana e administratës për ofertën për marrje në kontroll bëhet brenda **10 ditëve** nga data e publikimit dhe i komunikohet këshillit të punëmarrësve të shoqërisë, i cili harton një opinion të veçantë për pasojat e ofertës për marrjen në kontroll në marrëdhëniet e punës, që i bashkëlidhet opinionit të hartuar nga administrata.

Kufizimi me zgjedhje i masave mbrojtëse bëhet nga asambleja e përgjithshme, me shumicë të cilësuar votash dhe vendimi i asamblesë publikohet në faqen e internetit të shoqërisë tregtare, objekt i ofertës. Gjithashtu Asambleja e përgjithshme me shumicë të caktuar votash vendos moszbatimin e kufizimeve në lidhje me kalimin e aksioneve.

Ndryshimi i ofertës është një pikë tjetër me rëndësi e parashikuar nga ligji e cila mund të realizohet deri në një ditë pune përpara përfundimit të afatit të lejuar për pranimin e ofertës, si psh. Mundet të rrisë çmimin, të ofrojë një çmim alternativ, me vlerë të barabartë etj.

Oferta konkurruese për marrje në kontroll janë ofertat e bëra nga të tretët gjatë kohës së lejuar për pranimin e ofertës për marrjen në kontroll. Ligji parashikon rastet kur oferta konkurruese vlerësohet më e favorshme dhe nëse oferta në këtë rast miratohet oferta e mëparshme vlerësohet e pavlefshme. Ofruesi dhe shoqëria objekt i ofertës njofton Autoritetin dhe publikojnë, të dhënat për çdo shitje ose marrje në zotërim të titujve të shoqërisë, objekt i ofertës. Në rast të mbylljes pa sukses të një oferte, ofruesi nuk mund të bëjë një ofertë tjetër për titujt e shoqërisë, objekt i ofertës, brenda 1 një viti nga publikimi i rezultatit të ofertës.

Ofruesit i rezervohet e drejta për të kontrolluar të gjithë shoqërinë: nëse ka marrë të paktën 90 për qind të kapitalit që mbart të drejta vote dhe 90 për qind të të drejtave të votës të shoqërisë, objekt i ofertës, duke iu kërkuar zotëruesve të aksioneve të mbetura me të drejtë vote t'ia shesin atij këto aksione kundrejt një kundërvlere me kushte të barabarta, por vetëm nëse në dokumentin e ofertës është parashikuar një qëllim i tillë i ofruesit. Ofruesi mund të kërkojë edhe blerjen e aksioneve të mbetura me përparësi dhe çdo aksion tjetër pa të drejtë vote, që i shiten atij.

E drejta e aksionarëve të vegjël për t'u larguar zbatohet duke i kërkuar ofruesit të blejë aksionet kundrejt një cmimi të ofruar.

Ligji i ri parashikon rastin kur **ofruesi merr në zotërim tituj të shoqërisë**, objekt i ofertës, të cilët, nëse mbliidhen me titujt, që zotëronin para ofertës, i japin atij një përqindje të drejtash vote, të cilat i mundësojnë kontrollin mbi shoqërinë në fjalë, ofruesi, brenda 7 ditëve, njofton dhe publikon këtë fakt, si dhe, në mënyrë të saktë, të drejtat e votës që zotëron. Brenda 10 ditëve nga data e publikimit ofruesi i paraqet për miratim Autoritetit një dokument oferte dhe e publikon atë.

Oferta u drejtohet të gjithë zotëruesve të mbetur të titujve për të gjithë titujt që zotërojnë. Kur kontrolli është ndërmarrë në bazë të një oferte vullnetare, të publikuar sipas këtij ligji dhe drejtuar të gjithë zotëruesve të titujve për të gjithë titujt që zotërojnë, detyrimi për publikimin e ofertës, nuk zbatohet. Përjashtime nga detyrimi për të bërë ofertë parashikohet për atë kategori ofruesish të cilët si rezultat i blerjes se aksioneve të shoqërisë, objekt i ofertës, nuk marrin kontrollin e shoqërisë dhe nuk ndryshon personi që ka kontrollin e shoqërisë, objekt i ofertës.

Vendimet e Autoritetit janë objekt ankimimi në gjykatë. Ankimi në rrugë gjyqësore nuk e pengon ekzekutimin e vendimeve të marra nga Autoriteti në zbatim të këtij ligji.

Av.Agela FERIZAJ